STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 4 maj 2013

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON 5.9 MILIONE DOLLARE NE Ndihmë shtetërore për restaurimin e plazheve të Stejtën Ajlënd (Staten Island) të dëmtuara nga super stuhia Sendi (Sandy)

Projekti i restaurimit prej 5.9 milionë dollarë do të sigurojë mbrojtjen e nevojshme të lagjeve të banimit aty pranë

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se Shteti i Nju Jorkut (New York State) ka caktuar 5.9 milionë dollarë për punën e restaurimit të plazheve mjaft të rëndësishme në Stejtën Ajlën (Staten Island) që do të sigurojnë pengesa natyrore thelbësore ndaj stuhive të ardhshme. Puna e restaurimit e vlerësuar në 5.9 milionë dollarë përfshin ngritjen e niveleve të rërës, përfshirë punën e restaurimit të dunave, në plazhe të dëmtuara rëndë gjatë super stuhisë Sendi (Sandy). Plazhet e prekura janë Plazhi Nju Dorp (New Dorp Beach) Plazhi Jugor (South Beach), Sidër Grouv (Cedar Grove) dhe Okud (Oakwood). Kontrata pritet të jepet këtë javë dhe puna të fillojë pak më vonë pas kësaj.

"Kjo punë e restaurimit është vendimtare për mbrojtjen e komuniteteve të banimit në Stejtën Ajlënd (Staten Island) që janë bërë më të rrezikuara ndaj stuhive të ardhshme si rezultat i shkatërrimit të pashembullt të Sendit (Sandy)," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Duke vlerësuar rrezikun me të cilin u përballën këto komunitete të banimit pas Sendit (Sandy), mblodha një ekip të agjencive shtetërore, vendore dhe federale për të përshpejtuar këtë proces të restaurimit dhe për të bërë gjithshka brenda fuqisë tonë për të ruajtur këto komunitete në Stejtën Ajlënd (Staten Island). Jam i gëzuar se kjo punë është duke filluar, e cila do të restaurojë pengesat natyrore që janë kaq të rëndësishme për të mbrojtur banorët dhe komunitetet tona gjatë stuhive të rënda."

Kryetari i Distriktit Xhejms P. Molinaro (James P. Molinaro) tha, "Dëshiroj të përgëzoj Guvernatorin për këtë plan me vizion për të ndihmuar në restaurimin e plazheve të Stejtën Ajlënd (Staten Island) dhe për të mbrojtur pronarët e shtëpive nga stuhi të ardhshme. Uragani Sendi (Sandy) ndryshoi vijat tona bregdetare dhe shkatërroi prona. Shumë shtëpi në bregdet nuk kanë asnjë mbrojtje nga deti dhe janë të rrezikuara ndaj përmbytjeve gjatë gjithë vitit. Megjithatë, që nga dita e parë, Guvernatori ka qënë në terren duke ndihmuar që Stejtën Ajlënd (Staten Island) të restaurohet nga shkatërrimi i Sendit (Sandy). Tani Distrikti ynë do të përfitojë veçanërisht nga kjo iniciativë e re. Në emër të popullit të Stejtën Ajlënd (Staten Island) përgëzoj Guvernatorin për të gjithë udhëheqjen dhe mbështetjen e tij pas kësaj stuhie historike."

Albanian

Senatori Endrju Lanza (Andrew Lanza) tha, “Restaurimet e vijës sonë bregdetare në rrezik janë mjaft të rëndësishme për banorët e Stejtën Ajlënd (Staten Island), veçanërisht për ata që jetojnë në komunitetet në bregdet,” tha Senatori Endrju J. Lanza (Andrew J. Lanza). “Këto fonde do të lejojnë restaurimet e menjëhershme të pengesave që mbrojnë ata që jetojnë përgjatë vijës bregdetare, duke i bërë më të fortë dhe të pajisur më mirë për të parandaluar përmbytjen dhe për t’u rezistuar stuhive të ardhshme. Përgëzoj Guvernatorin Kuomo (Cuomo) për ndihmën e tij të vazhdueshme ndërsa punojmë për të rindërtuar komunitetet e shumta të shkatërruara nga urgani Sendi (Sandy).”

Senatorja Dajen Savino (Diane Savino) tha, “Në emër të fqinjëve tanë që duhet t’i mbrojmë nga sezoni i ardhshëm, falënderoj Guvernatorin Endrju Kuomo (Andrew Cuomo) për mbajtjen e përkushtimit të tij ndaj popullit të Stejtën Ajlënd (Staten Island); veçanërisht ndaj atyre që vazhdojnë të jenë të prekur nga uragani Sendi (Sandy), këto riparime do të sigurojnë njëfarë mbrojtje që humbi gjatë stuhisë që i ka bërë brigjet tona lindore dhe jugore edhe më të rrezikuara sesa ishin kur Sendi (Sandy) erdhi në tokë dhe shkaktoi kaq shumë shkatërrim dhe vdekje.”

Anëtarja e Asamblesë Nikol Maliotakis (Nicole Malliotakis) tha, “Ky është një lajm i shkëlqyer për banorët përgjatë Bregut Lindor (East Shore) shtëpitë e të cilëve u shkatërruan nga Sendi (Sandy) dhe dëshirojnë të rindërtojnë. Mbrojtja e komuniteteve tona nga oqeani është një përparësi dhe falënderoj Guvernatorin Kuomo (Cuomo) që na ndihmon të rindërtojmë një Stejtën Ajlënd (Staten Island) më të fortë, më të mirë dhe që të sigurojmë banorët nga stuhitë e ardhshme.”

Anëtari i Asamblesë Xhozef Boreli (Joseph Borelli) tha, “Bregu i Stejtën Ajlënd (Staten Island) është më shumë sesa një element shtesë i rëndësishëm për komunitetin tonë. Eshtë një mbrojte e rëndësishme për shtëpitë dhe lagjet tona. Restaurimi i vijës bregdetare të shkatërruar nga Sendi (Sandy) do të ndihmojë të sigurohemi se stuhitë më pak të forta nuk do të shkatërrojnë banorët e Stejtën Ajlënd (Staten Islanders) në të ardhmen. Nga Plazhi Jugor (South Beach) në Totenvill (Tottenville), do të duhet të shqyrtojmë çdo alternativë të mundshme për të siguruar se një katastrofë si kjo nuk ndodh më kurrë.”

Agjencitë pjesëmarrëse përfshijnë Departamentin e Mbrojtjes Mjedisore të Shtetit të Nju Jorkut (New York State Department of Environmental Conservation), Paraqet e Qytetit të Nju Jorkut (New York City Parks) dhe Korpusin e Inxhinierëve të Ushtrisë të SH.B.A.-së (U.S. Army Corps of Engineers). Projekti, i financuar me kërkesë të Guvernatorit Kuomo (Cuomo) nga FEMA përms programit të Ndihmës Publike (Public Assistance), synon të mbrojë shtëpitë në zonat më pranë plazheve nga ngjarje të stuhive të ardhshme, si Noristër (Nor'Easters), meqë super stuhia Sendi (Sandy) hoqi të gjitha dunat në këtë zonë të Stejtën Ajlënd (Staten Island).

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418

Albanian